

Dokumenti  
Nr. 164  
Br. 18.12.2023  
Data  
Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



## KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.23.11.2023, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pilana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

**Të pranishmit tjerë:** Drejtoret komunal, Fatime Pllana, udhëheqëse e sektorit të Arsimit, Afërdita Hashani, udhëheqëse e sektorit të tatimit në pronë, Festina Preniqi, zyrtare për marëdhënie me publikun,

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës nga DEFZH-ja, për aprovimin e vendimit për tatimin në pronë për vitin 2024
4. Shqyrtimi i kërkesës nga DKRS-ja, për dhënien në debat publik të Draft Statutit të Bibliotekës Komunale të Qytetit
5. Shqyrtimi i kërkesës nga DKA-ja. për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore
6. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit Komunal
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

**Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.**

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DEFZH-ja, për aprovimin e vendimit për tatimin në pronë për vitin 2024.**

**Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo kërkesë ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim dhe mund të them se është një e mirë që tatimi ka zbritë dhe sigurisht se në Kuvend do ta japim kontributin tonë.**

**Sami Ahmeti** – Sigurisht se jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në seancë sepse është seanca e fundit kur mund të miratohen ato norma tativore. Është e vërtetë se është vlera minimale, çka ne edhe në Kuvend do ta mbështesim, por edhe nëse kemi ndonjë vërejtje ose sugjerim do ta japim atje. Duke qenë se Gjykata kushtetuese, dje ka dalë me vendim në favor të vendimit që ne si Kuvend Komunal e kemi marrë, do të ishte mirë që deri në ditën e seancës të na përgatitet nga Ekzekutivi një përgjegje se si do të veprohet mëtutje sepse duke pasë parasysh vendimin e Gjykatës kushtetuese nga shpallja e atij vendimi që është dje në gazetën zyrtare, janë 15 ditë kohë kur ka mundësi me aplikue atë vendim sepse 15 ditë kohë kanë shkue para saj. Prandaj, në seancë të bisedohet për këtë çështje sepse në dallim prej Komunave tjera, ne nuk e kemi atë problem dhe ne si Kuvend veç kemi marrë vendim. Pastaj Ministria, ka marrë vendim që me pezullue atë vendim deri në një vendim të Gjykatës kushtetuese. Pra, do të ishte mirë që në seancën e Kuvendit, ta kemi një përgjegje se si do të veprojmë mëtutje, a kemi nevojë prapë me nxjerrë vendim apo jo.

**Kryesuesja** – Sqaron se vendimi nuk është shfuqizue, por ne e kemi pezullue vendimin me kërkesë të Ministrisë deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Gjykata dje ka vendos në favor të Komunës, sepse Komunat të cilat kanë marrë vendim kanë të drejtë me bë faljen e tatimit në pronë dhe sigurisht se këta qysh sot do të vazhdojnë me procedura. Meqë, ne nuk e kemi shfuqizue atë vendim dhe e kemi marrë me vullnet me Kryetarin dhe me të gjithë neve, atëherë besoj se ai vendim do të filloj të aplikohet.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DEFZH-ja, për aprovimin e vendimit për tatimin në pronë për vitin 2024.

#### Pika 4 e rendit të ditës

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DKRS-ja, për dhënien në debat publik të Draft Statutit të Bibliotekës Komunale të Qytetit.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

**Sami Ahmeti** – Jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DKRS-ja, për dhënien në debat publik të Draft Statutit të Bibliotekës Komunale të Qytetit.

#### Pika 5 e rendit të ditës

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesës nga DKA-ja. për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore

**Enver Gashi** – Ne si grup parlamentar jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe atje do ta japim kontributin tonë,

**Sami Ahmeti** - Në fakt sa e kuptova unë, kjo është për dalje në debat publik, kështu që jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DKA-ja. për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore.

#### Pika 6 e rendit të ditës

**Kryesuesja** – Paraqiti formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit Komunal.

**Enver Gashi** – Është një Komision që e kryen punën për çdo vit që është edhe obligativ sepse mund të ndodhë ndonjë ndryshim i vogël në Planin e punës të Kuvendit Komunal. Ne jemi për atë që edhe kjo pikë të shkoj në Kuvend dhe atje, të caktohet dhe votohet Komisioni, i cili do ti kryej këto punë.

**Sami Ahmeti** – Jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës, që është zakon dhe obligim të shkoj në seancë dhe atje, do të japim kontributin tonë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit Komunal.

#### Pika 7 e rendit të ditës

**Kryesuesja** – Paraqiti kérkesën e Kryetarit të Komunës, për Propozim-Vendimin nr.-II-1654, të dt.20.11.2023 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për zk.Llazarevë, Milloshevë. Kérkoj nga ju që Propozim-Vendimi i cekur më lartë të futet si pikë e 7 e rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit. Po ashtu, e kemi edhe Propozim-Vendimin nr.-II- 1655, të dt.20.11.2023 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për zk.Milloshevë dhe Obiliq dhe kérkoj që ky Propozim-Vendim të futet në pikën e 8 të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit.

**Enver Gashi** – Jemi dakord, por këto 2 Propozim-Vendime duhet të shkojnë një nga një.

**Sami Ahmeti** – Duke qenë se materiali na ka ardhë me vonesë nuk kemi ndonjë qëndrim, kështu që do të abstenojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal Propozim-Vendimin nr.-II-1654, të dt.20.11.2023 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për zk.Llazarevë, Milloshevë.

**Kryesuesja** - Kérkoj që të votohet Propozim-Vendimi nr.-II-1655, të dt.20.11.2023 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për zk.Milloshevë dhe Obiliq

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal Propozim-Vendimin nr.-II- 1655, të dt.20.11.2023 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për zk.Milloshevë dhe Obiliq.

**Kryesuesja** – Paraqiti kérkesën nga Fidan Ahmeti që për të gjitha bizneset e Komunës së Obiliqit, dita e diel të jetë ditë pushimi dhe propozoi që kjo kérkesë të shkon për shqyrtim ne DEFZH.

**Labinot Mirena** – Është mirë të kemi një takim me të gjitha bizneset që punojnë në Komunën e Obiliqit, të shikojmë se a janë edhe ata të pajtimit. Besoj se bizneset është dashtë të kenë një shoqatë të tyre që i përfaqëson bizneset dhe kur të marrim një vendim për të gjitha bizneset të iu ndalohet puna të gjithëve. Mendoj se Kryetari me DEFZH-në, duhet me pasë atë takim me bizneset dhe me ata bashkarisht me gjetë një model të arsyeshëm edhe atyre që iu konvenon edhe neve, sepse nëse myllen bizneset në Komunën e Obiliqit, ne duhet të dalim të furnizohemi dikund tjetër. Për mendimin tim nuk është e arsyeshme.

**Enver Gashi** – Ne e kemi bërë qysh në fillim një Rregullore interne këtu, që fillimi shët kérkesat duhet të shqyrtohen në Drejtore përkatëse, të cilat me një rekandim vijnë në Kuvend, në mënyrë që Kuvendi ta ketë një bazë me çka të merret. Në rastin konkret nuk specifikohen shumë gjëra që Drejtoria i kryen ato, konkretisht z.Labinot që e përmendi ku me u furnizue dhe arsyeshmëria pse me pushue të dielën. Unë e di se shumë biznese në program të tyre, të punës e kanë me pushue një ditë në javë sepse iu duhet atyre, por nëse Drejtoria e jepë një rekandim, ose ne dalim me një propozim tonin dhe e bëjmë një Rregullore.

**Labinot Mirena** – Kemi biznes jashtëzakonisht të suksesshëm në Komunën e Obiliqit, por që e ka pushim ditën e hënë.

**Kryesuesja** – Unë i shohë frizeret që punojnë të dielën dhe shumë sallone tjera, të ondulimit që mund të ndodhë të hënën, ose të martën e kanë ditë të lirë. Neve, si kérkesë na ka ardhë tash me nënshkrime, shihet lirish se në mars është bërë ai petition dhe është bukur e palogjikshme me gjithë respektin për z.Fidan me kerkue dhe për secilin kolegë që jemi këtu, po e zëmë një floktar, ose një berber apo çka është ai me kerkue bëma ti pushim kur ai vetë mundet me ia ngjité çelësin sepse askush nuk e pengon. Mbi të gjitha kryesuese, ti sigurisht e din se në qershor të vitit 2022, ne e kemi nxjerrë Rregulloren që i specifikon këto çështje dhe nuk obligohet askush, aq më tepër ditën e diele kanë mbetë vetëm disa biznese të cilat konsiderohen si kruciale që ne vetë kemi dhënë koment, kemi thënë mundësia këto ndërmarrje ndërtimore për shkak se njerëzit në fund të javës punojnë me qenë të hapura, por kryesisht ne kemi Rregullore për këtë çështje. Sido që të jetë nuk po dojmë me ia hudhë poshtë kérkesën z.Fidan, sepse mund të jetë se disa persona kérkojnë atëherë le të merren Drejtore përkatëse, por prapë se prapë Rregullorja jonë është e plotëfuqishme. Po ashtu, ku është inspeksioni, çka ka bërë inspeksioni besoj se këto gjëra në seancën e ardhshme munden me u shpjegue, po e përsërisë prapë pa dashtë me konsiderue kérkesë të keqe, apo të mirë sepse sigurisht se edhe ai është nxitë prej disa personave që kanë bërë kérkesë. Mirëpo, më duket kérkesë e palogjikshme sepse askush nuk e denon dikend pse e ka myllë lokalini e vet të dielën.

**Kryesuesja** – Neve, kërkesat qysh na vijnë edhe i prezentojmë në KPF, ia rekomandojmë Drejtorisë përkatëse, e cila pastaj vjen me një rekomandim në Kuvend dhe ne e kemi aprovue një Rregullore, që nëse ata dojnë me ndryshue diçka, atëherë duhet me ndryshue edhe Rregulloren.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan DEFZH-së, kërkesën nr.-I-33443/2023, të dt.16.11.2023, që për të gjitha bizneset e Komunës së Obiliqit, dita e diel të jetë ditë pushimi.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga MMPHI-ja, për harmonizimin e Planit lokal për cilësi të ajrit. DMM-ja, ka plotësuar dhe ndryshuar Planin e tillë bashkë me Ministrinë përkatëse dhe prapë e kanë sjellë për shqyrtim dhe aprovim në Kuvend në pikën të ndryshme.


**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që kjo kërkesë ti rekomandohet Kuvendit komunal.

**Sami Ahmeti** – Ky Plan është miratuar në Kuvend, është kontestuar vetëm një nen, apo një pikë ku ka qenë e paraparë kjo dhe Ministria, e ka kthye përgjegjen se tashmë kjo është në rregullë, kështu që jemi për atë që ky Plan të shkoj në seancë dhe të ndryshohet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DMM-ja, nr.-IX-121, të dt.21.11.2023, për Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, sipas rekomandimeve të Ministrisë së MMPHI-së.

Mbledhja përfundoi në ora 11:32'

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli

